

## I - INFORMACION I PERGJITHSHEM DHE POLITIKAT KONTABEL

### \*Emri Njesisë Ekonomike, Selia dhe Forma Ligjore

Shoqëria ORUÇI Shpk është krijuar si shoqëri Person Fizik me një ortak të vetëm, me Vendim Gjykatë 23001 datë 10.03.1999 Kukës. Veprimtaria e shoqërisë ORUÇI Shpk rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Selia Qendrore në të cilën shoqëria zhvillon aktivitetin e saj sipas Certificate Rregjistrimi të QKR datë 06.07.2016 me NIPT J88511208S është me Adrese Kryesore Lagjja Drinas, Rruga Kukës Tirane Km 2 Zona Kadastrale Nr.1543 Nr Pasurie 326 ND Qyteti Kukës

### \*Aktiviteti Kryesor i Njesise Ekonomike

Shoqëria ORUÇI Shpk ka si objekt veprimtarinë në: " Import-eksport, tregtim të mallrave të ndryshëm, aktivitete në fushën e ndërtimit, autosholle, hoteleri, tregtim me pakicë të karburanteve. Import- Eksport . Kërkim, shfrytëzim mineralësh të grupit I-II-III si dhe transport dhe ruajtje të lëndës plasesh për përdorim civil. Bar- Kafe dhe Restorant. Tregtim karburanti.Autoservis, lavazh, gomisteri i automjeteve dhe mbledhje skrapit të të gjitha llojeve. Kancelari, Shitje dhe blerje të pjesëve të ndryshme të të gjitha llojeve të automjeteve. Shitje dhe blerje të automjeteve të reja dhe të përdorura të të gjitha llojeve. Mirembajtje rutine dhe pastrim nga debora i të gjitha llojeve të rrugëve. Rikonstruksione në fushën e ndërtimit. Kontributi në shoqëri përfaqësohet nga kapitali i ortakut të vetëm.

### \*Zbatimi i rregullave të mbajtjes së kontabilitetit

Kontabiliteti është organizuar dhe mbajtur në pajtim me kërkesat e Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ngjarjet dhe veprimet ekonomike janë rregjistruar në regjistrat kontabel në mënyrë kronologjike dhe sistematike në programin e administrimit financiar dhe kontabel "FINANCA 5". Rregjistrimi i veprimeve ekonomike bazohet në Evidencën Mbështetëse. Veprimet janë nguriësuar me 31 Dhjetor 2020.

### \*Politikat Kryesore Kontabel.

Ndërtimi i Pasqyrave Financiare të shoqërisë (Balanci Kontabel) për vitin 2020 bazohet në Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe veçanërisht në SKK Nr. 2, në Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", Neni 4, pasi shoqëria plotëson kushtet për zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit. Shifrat e Pasqyrave Financiare të shoqërisë ( Balanci Kontabel ) për vitin 2020 janë të krahasueshme me vitin paraardhës, pasi janë zbatuar të njëjtat politika kontabel. Polinkat kontabel të Shoqërisë ORUÇI Shpk Shpk reflektojnë praktikën e këtij aktiviteti.

Mbajtja e Kontabilitetit bëhet nëpërmjet regjistrimit të veprimeve dhe fakteve ekonomike në ditar dhe llogari në mënyrë të kompjuterizuar në programin e administrimit financiar dhe kontabel "FINANCA 5".

Sistemi Kontabel i zbatuar për marrjen në llogari, matjen, klasifikimin dhe paraqitjen e të dhënave financiare bazohet mbi të drejtat e konstatuara.

Standarti Kontabel që përcakton parimet dhe rregullat e përgjithshme për të zbatuar në hartimin e pasqyrave financiare mbështetet në kërkesat e Ligjit Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Pasqyrat Financiare sigurojnë transparencën dhe të dhënat e nevojshme për vendimmarrje.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur bazuar në kontabilitetin ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimtarisë ekonomike.

Paraqitja dhe klasifikimi i elementeve të pasqyrave financiare është bërë në koherencë në të dy ushtrimet.

Aktiviteti Agfatgjatja Materiale (AAM) shoqëria nuk ka pasqyruar AAM për këtë vit ushtrimor

Inventaret paraqiten në formë materiale dhe furnizimesh për të përdorur në kryerjes së shërbimeve.

Inventari vlerësohet me koston e blerjes.

Shpenzimet janë kontabilizuar në bazë të dokumentit bazë të shpenzimeve.

Të ardhurat nga shitja janë kontabilizuar në bazë të faturave tatimore të shitjes.

## II - SHPJEGIME TË ZËRAVE TË PASQYRAVE FINANCIARE ( BILANCI KONTABEL)

Pasqyrat Financiare të vitit 2020 ( BILANCI KONTABEL) janë hartuar sipas formatit të përcaktuar në Standartin Kombëtar të Kontabilitetit Nr. 2.

Çelja e llogarive të vitit 2020 rakordon me mbylljen e llogarive të vitit 2019.

Grupet dhe postet për ushtrimin e mbyllur 2019 dhe ushtrimin paraardhës 2019 rezultojnë si më poshtë :

### SHËNIME: SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE

Periudha 1 Janar – 31 Dhjetor 2020

Shoqëria "ORUÇI" SHPK



## AKTIVI

Totali i AKTIVIT në ushtrimin e mbyllur 2019 rezultoi me Vlerë Neto 47,576,641 leke.

Aktivitet e shoqërisë përfaqësohen nga:

### I - AKTIVE AFATSHKURTËRA

me Vlerë Neto 15,790,187 Leke.

Aktivitet Afatshkurtëra përfaqësohen nga:

Gjendja e Mjetëve Monetare në 31.12.2020 e krahasuar paraqitet:

|               | 31 Dhjetor 2020 | 31 Dhjetor 2019 | Ndryshimi +/-  |
|---------------|-----------------|-----------------|----------------|
| Para në Bankë | 237,441         | 94,895          | 142,546        |
| Para në Arkë  | 229,726         | 10,871          | 218,855        |
| <b>Totali</b> | <b>467,167</b>  | <b>105,766</b>  | <b>361,401</b> |

I.b - Aktive të tjera financiare afatshkurtëra me vlerë 14,542,290 leke përfaqësohen nga:

-Detyrimet e klientëve ndaj shoqërisë për shitje shërbimesh për faturat e papaguara deri në datë 31.12.2020 në vlerën 12,386,399 leke, Tatim Fitimi i mbipaguar 228,672 leke, Kreditore 1,927,219 leke, Detyrimet e Ortakut ndaj shoqërisë për shumën 0 leke. Në datë 31.12.2020 klientet nuk kanë detyrime në monedhë të huaj ndaj shoqërisë. Për pasojë shoqëria nuk ka krijuar diferencë konvertimi (shpenzime ose të ardhura) nga konvertimi i detyrimit në monedhë të huaj me kursin në leke të monedhës së huaj në datë 31.12.2020.

Gjendja e Kërkesave të Arkatueshme në 31.12.2020 e krahasuar paraqitet:

|                | 31 Dhjetor 2020   | 31 Dhjetor 2019   | Ndryshimi +/-    |
|----------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Klientet       | 12,386,399        | 13,912,056        | (1,525,657)      |
| Tatim Fitimi   | 228,672           | 631,338           | (402,666)        |
| Tvsh Kreditore | 1,927,219         | 1,568,540         | 358,679          |
| <b>TOTALI</b>  | <b>14,542,290</b> | <b>16,111,934</b> | <b>1,613,631</b> |

I.c - Inventari Mallrave & Aseteve me vlerë kontabile i paraqitur 31.12.2020 paraqitet për 27,300,329 leke.

Gjendja e Inventarit në 31.12.2020 e krahasuar paraqitet:

|                    | 31 Dhjetor 2020   | 31 Dhjetor 2019   | Ndryshimi +/-    |
|--------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Inventari Mallrave | 780,730           | 7,605,101         | (6,824,371)      |
| Inventari Aseteve  | 31,786,452        | 19,995,228        | 11,791,224       |
| <b>TOTALI</b>      | <b>32,567,182</b> | <b>27,600,329</b> | <b>4,966,853</b> |

## DETYRIMET dhe KAPITALI

Totali i Detyrimeve dhe Kapitalit të shoqërisë në ushtrimin e mbyllur 2020 rezultojnë me Vlerë Neto 47,576,641 leke.

I - DETYRIME AFATSHKURTERA me Vlerë Neto 27,071,119 leke, që përfaqësohen nga:

I.a - Të pagueshme ndaj BANKA me vlerë 43,83, Të pagueshme ndaj furnitorëve me vlerë 19,435,802 leke, Paga 393,607 leke, Të pagueshme për sigurime shoqërore për shumën 284,507 leke, Detyrimi i tatim Fitimit mbi të Ardhurat 2,600 leke, detyrime ndaj Ortakut shumën 6,950,220 leke deri më 31.12.2020.

|               | 31 Dhjetor 2020   | 31 Dhjetor 2019   | Ndryshimi +/-    |
|---------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Furnitorët    | 19,435,802        | 11,962,294        | 7,473,508        |
| Pagat         | 393,607           | 0                 | 393,607          |
| Sig.shoq      | 284,507           | 539,951           | (255,444)        |
| Tap           | 2,600             | 7,800             | (5,200)          |
| Ortaku        | 6,950,220         | 6,950,220         | 0                |
| <b>TOTALI</b> | <b>27,071,119</b> | <b>19,460,265</b> | <b>7,610,854</b> |



**II - KAPITALI** në Vlerë Neto 20,505,522 Leke.

Kapitali i shoqërisë në vitin 2020 paraqitet me ULJE në shumën 3,532,242 leke.

\* Kapitali aksioner me vlerë 100,000 leke.

\* Rezerva Ligjore

75,954 leke

\* Fitimi i mbartuar në vite

23,861,810 leke

\* Humbja e vitit financiar

3,532,242 leke

Përfaqëson rezultatin sipas PASH për vitin 2020.

**III - INFORMACION SHPJEGUES PËR PASH-in.**

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve është përgatitur sipas Formatit Nr. 1 të përcaktuar në SKK Nr. 2. Të ardhurat nga shitja përfaqësohen kryesisht nga të ardhurat e shërbimeve të ndryshme.

| Emertimi                 | Shuma             | Monedha     |
|--------------------------|-------------------|-------------|
| Të ardhura të Tatueshme  | 16,323,316        | leke        |
| Të ardhura nga interesat | 0                 | leke        |
| <b>TOTALI</b>            | <b>16,323,316</b> | <b>leke</b> |

Shpenzimet e paraqitura në PASH dhe kryesisht shpenzimet e blerjeve të materialeve të para, punime dhe blerje furniturash nga të tretë janë shpenzime të regjistruara sipas faturave tatimore bazuar në cmimin e blerjes.

Shpenzimet për personelin përfaqësojnë fondin e pagave për vitin 2020.

Shpenzimet për të tjera përfaqësojnë Taksa vendore shpenzime bankare etj gjatë vitit 2020.

Shpenzimet financiare përfaqësojnë gjoha dhe demshperblime, humbje të ndryshme të shoqërisë, Shpenzime qeraje.

Shpenzimet kryesore për vitin 2020 detajohen :

| Emertimi                                  | Shuma             | Monedha     |
|-------------------------------------------|-------------------|-------------|
| Shpenzime për për materialet e konsumuara | 9,248,381         | leke        |
| Fond Page                                 | 6,988,381         | "           |
| Shpenzime Amortizimi                      | 860,747           | "           |
| Shpenzime të tjera                        | 2,757,772         | "           |
| Shpenzime diferenca negative kembimi      | 0                 | "           |
| <b>TOTALI</b>                             | <b>19,855,558</b> | <b>leke</b> |

**REZULTATI TË ARDHURA & SHPENZIME**

|                                        |            |
|----------------------------------------|------------|
| <b>Totali i të Ardhurave</b>           |            |
| Totali i shpenzimeve të njohura        | 16,323,316 |
| Humbja e vitit ushtrimor               | 19,855,558 |
| Shpenzime për Tatimin mbi fitimin 15 % | -3,532,242 |
| Fitimi Neto për Vitin 2020             | -3,532,242 |

**IV - INFORMACION SHPJEGUES PËR FLUKSIN MONETAR**

Pasqyra e Fluksit Monetar të vitit 2020 është përgatitur sipas formatit të përcaktuar në SKK Nr. 2, Metoda Indirekte. Sipas Pasqyrës së Fluksit të Parasë të vitit 2020 shoqëria paraqitet me rritje monetare 361,401 leke.

**V - INFORMACION SHPJEGUES PËR PASQYREN E LËVIZJES KAPITALIT**

Pasqyra e Lëvizjes së kapitalit është përgatitur sipas formatit të përcaktuar në SKK Nr. 2.

Sipas Pasqyrës së Lëvizjes së Kapitalit të vitit 2020 kapitali neto i shoqërisë rezulton me ulje 3,532,242 leke dhe totali i kapitalit shkon në shumën 20,505,522 leke.

**PËRFAQËSUESI I SHOQËRISË**

Isak ORUÇI

**SHËNIME: SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANCIARE**  
**Periudha 1 Janar – 31 Dhjetor 2020**  
**Shoqëria "ORUÇI" SHPK**

